



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KRUIJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË ARDHMËRIA
SHQIPTARE”, Z. PARID SHKËLQIM MIRI

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me shkresën nr. 986 prot., datë 15.02.2024, Këshilli i Bashkisë Krujë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Anila Bashkim Veseli, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Ardhmëria Shqiptare.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare, për këshillin e bashkisë Krujë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 05, z. Parid Shkëlqim Miri.

Me shkresën nr. 2796, prot., datë 24.09.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Krujë, z. Parid Shkëlqim Miri, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Ardhmëria Shqiptare” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DR-PASH-23528_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Parid Shkëlqim Miri, rezulton se ka deklaruar:

- *Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT” të Formularit të Vetëdeklarimit:*
- *pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar
“Është dënuar nga Gjykata Tiranë, me periudhë prove, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”;*
- *pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonje vepre penale? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar
“Është arrestuar në Tiranë, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”;*
- *pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi apo jo? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar
“Është dënuar nga Gjykata Tiranë, me periudhë prove, në vitin 2019 për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 2903 prot., datë 08.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2904 prot., datë 08.10.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Parid Shkëlqim Miri.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 11095/1 prot., datë 15.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Parid Shkëlqim Miri, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 15999/1 prot., datë 15.10.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Parid

Shkëlqim Miri, ku konstatohet se kandidati rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 Kodit Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Parid Shkëlqim Miri, në Këshillin e Bashkisë Krujë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Licela VELIU -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ -Drejtorja e Ligjshmërisë (në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)